

VENDIM
Nr.425, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV SOT 7”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe I Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas lincencës në nr.032/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “SOT 7” sh.p.k. për televizionin “TV SOT 7”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj